



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/30

Datë: 20.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndryshimi dhe plotësimi i Planit të Dokumenteve Strategjike për vitin 2015.
2. Në Planin e Dokumenteve Strategjike për vitin 2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihen këto dokumente strategjike:
 - 2.1. Projekt-strategjia për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i Veprimit 2015-2018 (Ministria e Punëve të Brendshme);
 - 2.2. Projekt-strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore (Ministria e Drejtësisë).
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/30

Datë: 20.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet dokumenti strategjik "Vizioni i Kosovës për Shkathtësitë 2020" me Udhërrëfyesin, Masat dhe Treguesit e tij.
2. Themelohet Grupi Ndërministror për zbatimin dhe monitorimin e dokumentit strategjik "Vizioni i Kosovës për Shkathtësitë 2020" me Udhërrëfyesin, Masat dhe Treguesit e tij me këtë përbërje:

2.1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,	Kryesues;
2.2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,	bashkë-kryesues;
2.3. Zyra për Planifikim Strategjik/ZKM,	anëtare;
2.4. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,	anëtare;
2.5. Ministria e Integritimit Evropian,	anëtare;
2.6. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,	anëtare;
2.7. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,	anëtare dhe
2.8. Ministria e Financave ,	anëtare.
3. Grupi Ndërministror për zbatimin dhe monitorimin e dokumentit strategjik në fjalë do të themelojë sipas nevojës Grupin Teknik, të përbërë nga institucionet e lartpërmendura.
4. Grupi Teknik do të merret me përgatitjen e raportit për zbatimin dhe monitorimin e këtij dokumenti, i cili do të prezantohet para Grupit Ndërministror për miratim.
5. Sipas nevojës dhe në bazë të vlerësimeve të Kryesuesit të Grupit Ndërministror, Grupit Teknik mund t'i shtohen edhe anëtarë të tjerë.
6. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij Vendimi.
7. Obligohen të gjitha ministrinë dhe institucionet tjera t'i kryejnë obligimet e parapara me këtë Vendim, të bashkëpunojnë dhe t'iu përgjigjen kërkesave të Grupit Teknik.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/30

Datë: 20.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës R6 Prishtinë-Han i Elezit, Sektori C1, Zonat Kadastrale Konjuh, Lipjan, Smallushë, Gadime e Eperme, Marec, Gadime e Ulët dhe Babush i Muhaxhereve, Komuna e Lipjanit dhe Zonat Kadastrale Dobratine dhe Gushtericë e Ulët, Komuna e Graçanicës, sipas tabelave bashkangjitura këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit, ne pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi.

6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAJA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/30

Datë: 20.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohet shpronësimi me krijimin e të drejtës së servitutit për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Linjës Nr. 1806 të NS 110kV Gjakova1 dhe Gjakova 2, ndërtimi i shtyllave elektrike dhe vendosja e stabilimenteve për zgjerim të rrjetit energjetik me kompensimin e dëmeve të pronave të pronarëve në dobi të KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut" Sh.A.), Zonat Kadastrale Bardhasan, Qerim dhe Gjakovë, Komuna e Gjakovës, sipas tabelave bashkangjitura këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit, ne pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi.

6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Kompania Publike "Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut" Sh.A. (KOSTT) do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/30

Datë: 20.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr.03/L-221, 04/L-165, nr. 04/L-194, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 21,172 euro (10,507 euro për vitin 2014 dhe 10,665 euro për vitin 2015) për Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë për përmbushjen e kontributeve vjetore të Republikës së Kosovës për vitet 2014 dhe 2015 që dalin nga anëtarësimi si anëtar i ri me status vëzhgues.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 131 dhe bartën në OB me kod 201 Ministria e Financave nën-programi Thesari, me kod 112, në kategorinë ekonomike Subvencione dhe Transfere. Mjetet do të transferohen në xhirollogarinë e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/30

Datë: 20.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr.04/L-024 për Ndihmën Shtetërore, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni i Ndihmës Shtetërore në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministri i Financave, Kryesues;
 - 1.2. Ministri për Integrim Evropian, anëtar;
 - 1.3. Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, anëtare;
 - 1.4. Përfaqësues i shoqërisë civile, anëtar dhe
 - 1.5. Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, anëtar.
2. Anëtarët e Komisionit emërohen për një periudhë prej katër (4) vjetësh.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen vendimet e Qeverisë të Republikës së Kosovës Nr. 11/93 i datës 04.10.2012 dhe Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit Nr. 08/150 i datës 02.10.2013 për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Ndihmën Shtetërore.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/30

Datë: 20.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 150,000,00 euro, nga Shpenzimet e paparashikuara, nën programi Shpenzimet e paparashikuara me kod 131, kategoria ekonomike Rezerva dhe barten në Zyrën e Kryeministrit, nën programi Ministri pa portofol 1, kodi 260 kategoria e mallrave dhe shërbimeve, për përmbushjen e agjendës së Dialogut ndërshtetëror të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian në mes të Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, përkatësisht për Ministrinë pa Portofol 1.
2. Koordinatorit Politik për Bisedime në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë z. Blerim Shala, i emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 16 prill 2015 i ndahet një Zyrë brenda ndërtesës së Zyrës së Kryeministrit, gjithashtu për punën e tij do ta ndihmoj dhe mbështes stafi i Ministres pa Portofol dhe Zyra e Kryeministrit.
3. Kompensimi i koordinatorit për shërbimet e kryera do të bëhet nga kategoria Ekonomike mallra dhe shërbime nga buxheti i përcaktuar në pikën 1. të këtij vendimi i cili do të jete i barabartë me pagën e Zëvendësministrit.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/30

Datë: 20.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-217 për Azil, Rregullores Nr. 10/2014 të Punës së Komisionit Kombëtar për Refugjatë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. I vazhdohet mandati anëtarëve të Komisionit Kombëtar për Refugjatë, në këtë përbërje:

1.1. Naim Shala	- MPB,	Kryetar;
1.2. Leunora Ahmeti	- MPMS,	zëvendëskryetare;
1.3. Jeton Oruçi	- ZSHNJ-ZKM,	anëtar;
1.4. Agron Maxhuni	- MAPL,	anëtar;
1.5. Arben Kqira	- MD,	anëtar;
1.6. Mirvete Kelmendi	- MSH,	anëtare dhe
1.7. Nuhi Osmani	- MKK,	anëtar.

2. Komisioni është i pavarur në punën e tij.

3. Mandati i Komisionit është 3 (tre) vjet dhe veprimtarinë e tij e ushtron në bazë të Ligjit për Azil dhe legjislacionit relevant në fuqi.

4. Komisioni vendos në këshilla prej tre anëtarësh, dhe i njëjti merr vendime me shumicë votash.

5. Përfaqësuesi i UNHCR-it merr pjesë në punën e Komisionit në cilësinë e vëzhguesit.

6. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për sigurimin e hapësirës dhe mbështetjes teknike për Komisionin me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së tij.

7. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë nr. 04/70 i datës 18.04.2012.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/30

Datë: 20.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe 16 të Ligjit Nr. 04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për aprovimin e shtyrjes së afatit të regjistrimit të diasporës dhe mërgatës

1. Aprovohet shtyrja e afatit të regjistrimit aktiv të diasporës dhe mërgatës deri në dhjetor të vitit 2016. Ndërsa raportet e para me të dhëna finale të bëhen gjate periudhës 1 janar-31 maj 2017.
2. Obligohet Ministria e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/30
Datë: 20.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim rregullohet mënyra e zbatimit të Vendimit të Qeverisë Nr. 06/29 të datës 15.05.2015 që ka të bëjë me pagesën e shtesës mbi përvojën e punës.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi mjetet sigurohen nga:
 - 2.1. Kursimet brenda Organizatave buxhetore nga kategoria e Pagave dhe mëditjeve dhe kategoritë tjera ekonomike, përfshirë këtu edhe mos plotësimin e vendeve të lira të punës, dhe
 - 2.2. Nën-programi me kod 285 Kontigjenca për paga për pagesën e përvojës së punës të ndara në Ministrin e Financave
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen të gjitha organizatat buxhetore, Ministria e Administratës publike dhe Ministria e Financave.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë